

lajmi.net

Arrestohen për terrorizëm pesë persona në Pejë, u gjenden armë e pajisje tjera

LAJME

LAJMI I FUNDIT

lajmi.net

Më afër lexuesit.

15/05/2023 13:58

f

✈

🔗

Drejtoria Kundër Terrorizmit, në koordinim me Prokurorinë Speciale, pas hetimeve disamujore, sot, me datën 15/05/2023, ka ndërmarrë operacion policor në gjashtë lokacione, në rajonin e Pejës, Prishtinës dhe Gjilanit, për zbatimin e urdhërësës për kontroll, të lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti Special.

Si rezultat i këtij operacioni, nën dyshimin e kryerjes së veprave penale ‘shtytje në kryerjen e veprës terroriste, sipas nenit 134 të KPRK-së’ dhe ‘mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve’, sipas nenit 366 të KPRK-së, janë arrestuar pesë persona të dyshuar (L. B., B. V., E. B., A. H. dhe A. S.), ndaj të cilëve janë duke vijuar procedurat ligjore.

Të dyshuarit e lartcekur janë të njohur për Policinë e Kosovës, si të dyshuar për përfshirjen e tyre të mëparshme në disa vepra tjera penale në rajonin e Pejës.

Në cilësinë e provave dhe dëshmive materiale janë sekuestruar:

Tri (3) revole,

Një armë automatike AK-47,

Një armë rekreative pneumatike,

Pajisje elektronike dhe dëshmi tjera relevante lidhur me rastin.

Me urdhër të prokurorit të Prokurorisë Speciale, të dyshuarit ndalohen në ndalim policor, në kohëzgjatje prej 48 orëve. **/Lajmi.net/**

Artikuj të ngjashëm



May 16, 2023
I përkeqësohet gjendja nënës së ish-presidentit Thaçi



May 16, 2023
Qorton Oda Amerikane: Vonesa në normalizim me Serbin pengon zhvillimin ekonomik



May 16, 2023
Largohen disa shitës ilegalë në Prishtinë, krekoset Përparim Rama



May 16, 2023
Haki Kadriu tregon se a ka pasur pjesëtarë të komunitetit LGBTI...



May 16, 2023
Kurti: Serbia nuk është e interesuar ta zbatoj në tërësi marrëveshjen



May 16, 2023
Pranohet kërkesa e mbrojtjes së Veselit: Një dokument shtohet në listën...

LAJME TË FUNDIT

Zhaklina i kundërpërgjigjet Nita Latifit, e quan pseudo-këngëtare...

I përkeqësohet gjendja nënës së ish-presidentit Thaçi

Dy objektivat e Arsenalit do t'i zënë vendin...

Vazhdojnë "dramat" e Fjolla Morinës, kësaj radhe akuzon...

Other Links

- Fact-Checking Policy
- Ethics Policy
- Corrections Policy
- Ownership & Funding Information
- Editorial Team Information